

## Shpjegime

### Mbi gjetjet e rezultuara gjatë procedurës së verifikimit të kandidaturës

**Drejtuar:** Këshillit të Emerimeve në Drejtësi

Relatorëve

Znj.Arta Marku

Z. Fatri ISLAMAJ

Znj. Fatjona MEMÇAJ

Z. Ardian DVORANI

Të nderuar zonja dhe zoterinj,

Më datë 03.05.2019 kam marrë njoftimin tuaj për paraqitjen me shkrim të shpjegimeve mbi gjetjet e rezultuara gjatë procedurës së verifikimit të kandidaturës.

Në përgjigje të njoftimit tuaj datë 03.05.2019, po ju paraqes shpjegimin, qëndrimin dhe kërkesat e mia lidhur me gjetjet tuaja.

#### **I. Shpjegime rreth gjetjeve të KED**

Në lidhje me gjetjet tuaja jap shpjegimet dhe sqarimet si vijon:

1. Më datë 22.02.2018 kam paraqitur kërkesë për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës, duke paraqitur edhe dokumentacionin përkatës në përputhje me nenin 125 pika 4 e 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
2. Më datë 23.01.2019 kam paraqitur kërkesë për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit përpara afatit, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë duke paraqitur edhe dokumentacionin përkatës në përputhje me nenin 125 pika 4 e 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.



3. Më datë 18.03.2019 kam paraqitur kërkesë për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese (vakancë e plotë), të shpallur nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë duke paraqitur edhe dokumentacionin përkatës në përputhje me nenin 125 pika 4 e 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
4. Më datë 23.03.2019 kam paraqitur kërkesë për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese (vakancë e plotë), të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë duke paraqitur edhe dokumentacionin përkatës në përputhje me nenin 125 pika 4 e 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
5. Më datë 05.04.2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, nëpërmjet postës elektronike, më ka njoftuar për fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave për të cilat kisha shprehur interesin për të kandiduar në vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese. Në bazë të këtij njoftimi më kërkohej që të paraqitesha pranë zyrës së posacme të KED në Gjykatën e Lartë, deri më datë 10.04.2019, për të firmosur deklaratën përkatëse lidhur me pajisjen me formularët e deklaratave, autorizimeve dhe informacioneve të cilat duheshin plotësuar nga ana ime.
6. Më datë 10.04.2019 jam paraqitur pranë zyrës së posacme të KED në Gjykatën e Lartë, ku kam nënshkruar deklaratën përkatëse.
7. Më datë 12.04.2019 kam paraqitur pranë kësaj zyre të gjitha formularët e deklaratave dhe autorizimeve, të cilat duheshin paraqitur brenda një afati 5 ditor.
8. Duke njohur detyrimin që kisha për të bërë deklarinin e pasurisë dhe të interesave private sipas nenit 3/1 të ligjit nr.9049, dt.10.04.2003 "Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë" i ndryshuar, që në muajin janar të vitit 2019 kam filluar procedurat për mbledhjen e dokumentacionit lidhur me burimin e të ardhurave të mia dhe personave të lidhur me mua, pranë institucioneve përkatëse shtetërore dhe private, që administrojnë dokumentacionin lidhur me këto burime. Bashkangjitur kësaj shkrese ju paraqis edhe dokumentacionin përkatës. Me gjithë përpjekjet e mia, ishte e pamundur marrja e të gjithë dokumentacionit që lidhet me burimin e krijimit të pasurive dhe detyrimeve të mia dhe personave të lidhur me mua.
9. Pas datës 10.04.2019, kur jam njoftuar zyrtarisht për detyrimin tim për të bërë deklarinin e pasurive dhe interesave private në bazë të nenit 3/1 të ligjit nr.9049/2003, kam filluar verifikimin e gjendjes së llogarive bankare që kisha unë dhe personat e lidhur me mua me qëllim për të bërë deklarinin e saktë të tyre. Duke qenë se bashkëshortja ime, si person i



lidhur, e cila ushtron detyrën e noteres, ajo për shkak të detyrës, disponon tre lloje llogarish në banka: 1. Llogari personale, 2. Llogari si person fizik, 3. Llogari për transaksionet e klientëve. Gjatë mbledhjes së informacionit për gjendjen e llogarive konstatuam, se banka nuk i kishte pasqyruar saktësisht veprimet në llogari sipas llojit të tyre. Shumat e llogarive të transaksioneve në ndonjë rast ishin derdhur në llogarinë e personit fizik, gjë e cila nuk duhet të ndodhte. Ky gabim i bankës ka sjellë si rrjedhojë rritjen fiktive të të ardhurave të bashkëshortes time, ndërkohë që shumat e kaluara në llogarinë e personit fizik në fakt nuk ishin të saj, si person fizik por i takonin llogarisë së transaksioneve. Korigjimi i këtyre gabimeve kërkon kohë si dhe duhet të realizohet nga vetë subjektet që kanë kryer transaksionet.

10. Ndodhur para fakteve të mësipërme, më datë 25.04.2019, i kam paraqitur kërkesë me shkrim ILDKPKI për zgjatjen e afatit për dorëzimin e formularit për deklarimin e pasurisë dhe të interesave private. Bashkangjitur kërkesa ime, e marrë nga ILDKPKI më datë 25.04.2019, nga punonjësja Suela Cana.
11. Po në këtë datë kam vënë në dijeni edhe KED për kërkesën time, paraqitur pranë ILDKPKI, me nr.286 prot., dt.25.04.2019.

## II. Qëndrim rreth gjetjeve

Rreth gjetjes së konstatuar nga ana juaj, me njoftimin datë 03.05.2019 shpreh qëndrimin tim si vijon:

1. Nga ana ime nuk është refuzuar deklarimi i pasurisë dhe interesave private. Në kërkesën time drejtuar ILDKPKI dhe KED, në ditën e fundit të afatit prej 15 ditësh, për dorëzimin e formularit të deklarimit të pasurive dhe interesave, nuk kam shprehur refuzimin tim për të deklaruar pasuritë dhe interesat private, por kam sqaruar pamundësinë time për të dorëzuar në afat duke parashtruar edhe rrethanat objektive që më pengonin për të realizuar një deklarim të tillë. Ndodhur përpara kësaj pamundësie objektive, kam kërkuar zgjatjen e afatit për dorëzimin e deklarimit, në mënyrë që ta paraqisja atë të plotë e të saktë, duke patur parasysh edhe përgjegjësinë që sjell pavërtetësia e deklarimeve të tilla si dhe pamundësinë për të bërë korigjime pas deklarimit referuar nenit 3/1 të ligjit nr.9049/2003. Edhe neni 5 i ligjit nr.9049/2003 e lidh konceptin e refuzimit me personat në funksion dhe jo me kandidatët.
2. Duke qenë se deklarimi i pasurive dhe interesave private për kandidimin tim në institucionet e drejtësisë bëhej për herë të parë, pasi nuk kisha bërë deklarime të mëparshme në zbatim të ligjit nr.9049/2003, i ndryshuar, dhe veprimtaria ime dhe e



personave të lidhur me mua në sektorin privat është për më shumë se 20 vjet, mbledhja e të gjithë dokumentacionit e saktë dhe të vërtetë për burimin e të ardhurave në krijimin e pasurisë për një afat 15 ditor, ka qenë objektivisht e pamundur. Bashkëshortja ime që nga viti 1994 punon si notere privat ndërsa unë që nga viti 2001 punoj si avokat. Për mbledhjen e dokumentacionit financiar pranë institucioneve që kanë për detyrë administrimin dhe ruajtjen e tyre kërkon një kohë të gjatë.

### III. Kërkesa rreth gjetjeve

Duke marrë parasysh shpjegimet dhe qëndrimet e mia që i parashtrova më sipër, kërkoj nga ana juaj:

1. Të mos konsiderohet si refuzim, mos paraqitja nga ana ime e formularit të deklarimit të pasurive dhe interesave, për arsyt objektive të parashtruara më sipër.
2. Caktimin e një afati të ri të arsyeshëm, jo më pak se 1 muaj, për dorëzimin e formularit të deklarimit të pasurive dhe interesave private pranë ILDKPKI.
3. Nëse nuk cmohet e arsyeshme nga ana juaj, që të më caktohet një afat i ri për këtë deklarim, me qëllim që kandidatura ime të mos përbëjë shkak për vonesë në plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, heq dorë nga kandidimet e paraqitura nga ana ime deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë.

Bashkangjitur:

1. Kërkesë dt.25.04.2019 drejtuar ILDKPKI, pranuar nga ILDKPKI
2. Kërkesë dt.25.04.2019 drejtuar ILDKPKI, pranuar nga KED
3. Kërkesë nr.837, dt.30.01.2019 drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore,
4. Kërkesë nr.838, dt.30.01.2019 drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore
5. Kërkesë nr.836, dt.30.01.2019 drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore
6. Kërkesë nr.839, dt.30.01.2019 drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore
7. Dëftesa pranimi të objekteve postare dhe lajmërim marrje, për kërkesat drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë

Tiranë më 06.05.2019

AVNI SHEHU

